

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr.4103, datë 19.9.2011

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË TRAJNIMEVE TË SIGURISË NË
AVIACIONIN CIVIL

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 106, pika 2(b)(ii) të ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit”,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e “Programit kombëtar të trajnimeve të sigurisë në aviacionin civil”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani